
	Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo Komuna e Prishtinës Opština Priština –Municipality of Prishtina	
---	--	---

Datë/a:	23.04.2020
Për/ Za/ To:	“Beni Com&Linda &Infrastruktura.”
CC:	Departamenti i Prokurimit
Nga/ Od/ From:	Zekë Bardhaj – Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit Komuna e Prishtinës
Tema/ Subjekat/Subject:	Vendim për Rishqyrtim të Kërkesës



Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për rishqyrtim** të datës 21.04.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik “Beni Com&Linda &Infrastruktura”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “**Ndërtimi i parkut rekreativo-sportiv në Dardani dhe rregullimi i hapësirës**”, me Nr. të Prok: 616 19 7632 511 nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet në tërësi si e pa e bazuar kërkesa për rivlerësim e parashtruar nga “Beni Com&Linda &Infrastruktura” e datës 21.04.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i parkut rekreativo-sportiv në Dardani dhe rregullimi i hapësirës”, me Nr. të Prok: 616 19 7632 511, kundër Vendimit të AK –së, të datës 17.04.2020.

2. Mbetet në fuqi vendimi i AK datë: 17.04.2020.

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i parkut rekreativo-sportiv në Dardani dhe rregullimi i hapësirës”, me Nr. të Prok: 616 19 7632 511 “ta vazhdoj sipas njoftimit të datës 17.04.2020.

4. Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës me datë 22.04.2020 ka shqyrtuar kërkesën e grupit të OE-ik “Beni Com&Linda&Infrastruktura” dhe ka konstatuar si vijon:

-Pretendimi 1 se Autoriteti Kontraktues nuk ka respektuar nenin 1 të LPP-ik është plotësisht i pa bazuar pasi që ky nen parasheh shfrytëzimin efikas të mjeteve publike duke pasqyruar parasysh çdoherë se kontrata duhet të jepet tenderuesit të përgjegjshëm me çmimin më të ulët e jo tenderuesit me çmim më të ulët. Nga kjo rrjedh se ju si tenderues i pa përgjegjshëm nuk mund të propozoheni për dhënje të kontratës dhe se Vendimi i AK-së është në përputhje me dispozitat ligjore. Pretendimi që ka të bëjë me faktin se ju jeni propozuar së pari për dhënje të kontratës e pastaj është propozuar nga komisioni i rivlerësimit një tenderues tjetër ka të bëjë me faktin që ju e dini se aktiviteti është kthyer në rivlerësim sipas kërkesave për rishqyrtim të dy tenderuesëve tjerë pasi që është konstatuar se ka konflikt interesi brenda ndërmarrjes tuaj, si që është sqaruar në Vendimet për aprovimin e kërkesave të tyre dhe në raportin e rivlerësimit dhe se lideri i konzorciumit tuaj nuk plotëson kërkesat e referencave në vlerën e kërkuar prej 60% nga vlera totale e kërkuar ;

- Pretendimi 2 lidhur me mosrespektimin e nenit 7 të LPP-ik është poashtu plotësisht i pa bazuar, pasi që ky nen ka të bëjë poashtu me rastet kur tenderuesit janë të përgjegjshëm dhe nuk mund të konsiderohet diskriminim trajtimi i një tenderi si i pa përgjegjshëm kur nuk plotëson kërkesat e FDT-së si që është rasti i tenderit tuaj, por diskriminim do të ishte veprimi i kundërt me këtë;

- Pretendimi numër 3 se Autoriteti Kontraktues nuk ka respektuar kriteret e vlerësimit sipas nenit 52 është poashtu i pa qëndrueshëm pasi që edhe këtu kemi të bëjmë me kriterin e çmimit më të ulët të tenderuesit të përgjegjshëm e jo për çmimin më të ulët pa marrë parasysh se ai plotëson tenderuesi kërkesat e Dosjes së tenderit apo jo. Lidhur me këtë pikë ju sqarojmë se kërkesa ka qenë mjaftë e qartë për liderin e grupit (60% e referencave) dhe ato referenca që ju pretendoni se janë të natyrës së njejtë apo të ngjajshme nuk qëndron, pasi që nuk kanë të bëjnë me rregullimin e parqeve, shesheve apo hapësirave publike, por me punime të rrugëve;

- Pretendimi 4 se Autoriteti Kontraktues nuk ka bërë vlerësimin sipas nenit 59 është poashtu i pa bazuar për faktin se sipas këtij neni një tender trajtohet si i përgjegjshëm vetëm nëse i plotëson të gjitha kërkesat e Dosjes së tenderit. Pasi që tenderi juaj nuk ka plotësuar këto kërkesa është trajtuar si i pa përgjegjshëm në harmoni me këtë nen.

- Pretendimi se hartuesi i projektit, repektivisht anëtari i grupit hartues Safet Lipovica, nuk është paraqitur si i angazhuar në këtë projekt dhe se kjo nuk paraqet konflikt interesi ua përkujtojmë se Kodi etik i Prokurimit në pikën 5.4 ka përcaktuar në mënyrë të qartë rastet e konfliktit të interesit dhe që ta keni më të qartë ua paraqesim në vijim tekstin e të njejtë:

“5.4 Janë tri pika të caktuara të një procedure të prokurimit publik, ku mund të lind konflikti i interesit:

-brenda autoritetit kontraktues

- ndërmjet autoritetit kontraktues dhe tenderuesit

-mes atij që ka përgatitur specifikimet teknike / dokumentet e tjera mbështetëse dhe tenderuesit

Për qëllime të kësaj deklarate, individit konsiderohet se ka konflikt interesi kur individit, ose ndonjë anëtar familjeje ose bashkëpunëtor i tij:

Ka një interes aktual ose potencial financiar ose të llojit tjetër i cili dëmton ose mund të dëmtojë pavarësinë e gjyqimit të individit gjatë kryerjes së detyrave ndaj organizatës, ose Mund të ketë ndonjë përfitim material financiar ose tjetër, nga posedimi i informacionit i cili është i natyrës konfidenciale. “Familja” e individit përfshin gruan, prindërit, vëllezërit dhe motrat, fëmijët dhe të afërmit tjerë.

5.5 “Bashkëpunëtor” i individit konsiderohet çdo person, organizatë ose ndërmarrje në të cilën ose me të cilën individi ose ndonjë anëtar i familjes së tij/saj është:

Drejtor, zyrtar, punëtor, anëtar, partner, ose dorëzues;

Ka ndonjë interes financiar që ia mundëson atij të veprojë i vetmuar ose në bashkëpunim me të tjerët për të ushtruar kontroll ose ndikim të madh mbi politikat;

Ka ndonjë lidhshmëri tjetër materiale.

Ua përkujtoj se në rastin tuaj Safet Lipovica është hartues i projektit dhe nënshkruar i kontratës për hartimin e projektit dhe se sipas dëshmive që i keni dorëzuar ju i njejtë është punëtor i rregulltë në ndërmarrjen tuaj “Beni Com”.

Lidhur me këtë pikë edhe pretendimi juaj se ka konflikt interesi edhe te tenderuesi i propozuar për kontratë lidhur me punët e Naser Surdullit, ju sqarojmë se sipas dëshmive të ofruara nga ky tenderues rrjedh se i njejtë ka qenë i punësuar në atë kompani deri në vitin 2018, respektivisht pesë muajt e parë të këtij viti dhe në asnjë evidencë tjetër nuk është emri i tij në listën e të punësuarëve të të njejtës, ndërsa ua përkujtojmë se projekti është punuar në muajin qershor të vitit 2019. Sa i përket pretendimit se i njejtë është i punësuar në atë kompani në këtë vit, ju sqarojmë se Autoriteti Kontraktues vlerëson dokumentet që kanë të bëjnë deri me datën e dorëzimit të tenderit e jo pas asaj date, e që sipas dëshmive të ofruara deri në datën e hapjes 09.12.2019 i njejtë nuk figuron si i punësuar.

Bazuar në këtë konstatim se pretendimi juaj se ka konflikt interesi edhe te ky OE-ik është plotësisht i pa bazuar.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në konstatimet e paraqitura më lartë ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit